




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT**



Nr. _____ Prot.

Vlorë më, 27. 09. 2019

VENDIM

Nr. 45, datë 27. 09. 2019

**PËR
MATERIALET E PARAQITURA PRANË BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

Mbështetur në nenin 49, pika 1, të Ligjit Nr. 80/2015 *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"*, si dhe nenit 25, pika 1, shkronja dh, dhe pika 2 e Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 30. 08. 2019,


VËREN SE:

Pranë sekretarisë së Bordit të Administrimit janë përcjellë:

1. Shkresa e Rektorit nr. 1107/1 datë, 19. 09. 2019 "Shkresë Përcjellëse" me anën e të cilës përcillet shkresa e Dekanit të Fakultetit të Ekonomisë nr. 146/2 prot, datë 06.09.2019 për pagesën e punës për aplikimin në projektin Folk Fest si dhe
2. Shkresa e Zv. Rektorit Akademik nr. 443/ 4 prot, datë 16.09.2019 "Përcjellje Propozimi" me anën e së cilës përcillet propozimi i Dekanit të Fakultetit të Shkencave Humane nr. 443/1 prot, datë 26.03.2019 lidhur me krijimin e Departamentit të Histori-Gjeografisë.

Bordi Administrimit vë re se shkresat në fjalë, për të cilat kërkohet miratimi i BA-së, nuk shoqërohen me asnjë lloj relacioni shoqërues si p.sh. nesë janë plotësuar te gjitha kriteret e VKM nr. 418, datë 10. 05. 2017 "Për standartet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre", numri i studentëve qe ndjekin programin e Histori- Gjeografisë, nevojës pse ka lindur krijimi i një departamenti të ri etj.

Si dhe në rastin e shkresës nr. 1107/1 datë 19.09.2019 shkresa është e pashoqëruar me relacionin nga Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Insitucional apo



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT**

Sektori Juridik mbi ligjshmërinë e tij, bashkëlidhur këtij material dhe relacioni financiar nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse se sa është kostua për pagesën e këtyre orëve.

Mbi të gjitha, Bordi i Administrimit risjell në vemendjen Tuaj se ai është shprehur dhe disa herë të tjera me shkresa përcjellëse se materialet e paraqitura pranë këtij organi kolegjal duhet të vijnë në formën e propozimit dhe gjithmonë të shoqëruar me relacionet përkatëse, të cilat të lëshohen në sekretarinë e Bordit nga zyra e protokoll arkivës me vulë lidhëse.

Nga sa u parashtrua mësipër, në përfundim BA në mbledhjen e datës 27. 09. 2019,

VENDOSI:

1. Të mos marrë në shqyrtim asnjë shkresë e cila vjen thjesht në formën e shkresës përcjellëse të kërkesave të ndryshme, dhe që rezulton e pashoqëruar me relacionet shoqëruarë-justifikuese, relacionet e drejtorive përkatëse sipas argumentit dhe mbi të gjitha relacionin e Sektorit Juridik mbi ligjshmërinë dhe atë të Financës mbi efektet financiare.
2. BA do të marrë në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur pranë sekretarisë së tij, i cili vjen në formën e një propozimimi (nga drejtoria propozuese) dhe vetëm nëse është i plotësuar me relacionet financiare dhe materialin shoqëruarë-justifikues nga drejtoritë përkatëse, apo organet dhe autoritetet që kanë propozuar vendimarrjen.
3. BA autorizon sekretarinë e vet që në momentin që dorëzohet një material jo në formën e kërkuar, ta përcjelli atë në drejtoritë përkatëse të Rektoratit me qëllim plotësimin e propozimit me materialet dhe relacionet shoqëruarë, duke ndjekur procedurën e parashikuar nga legjislacioni në fuqi.
4. Vendimet e Senatit Akdemik në të cilat i propozohet BA apo kërkohet miratim i mëtejshëm i Bordit të Administrimit, duhet të shoqërohet me të gjithë materialin shoqëruarë i cili është paraqitur nga propozuesi në Senatin Akdemik në momentin e vendimarrjes, si dhe me relacionin e drejtorisë përkatëse të fushës së diskutimit dhe relacionin e sektorit juridikë dhe atij të financës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Kopje e këtij Vendimi i përcillet të gjitha Autoriteteve dhe Organeve drejtuese, strukturave pranë Rektoratit si dhe Njësisë Kryesore dhe atyre Bazë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Anjeza Shiko – Anëtar

Rajmonda Simoimeri – Anëtar

Enrik Mehmeti – Anëtar

Dr. Elsajed Rexhaj – Anëtar

Dr. Enida Pulaj – Anëtar

Dr. Marinela Muço - Anëtar

Dr. Ervis Mocka - Kryetar

